- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktajnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**Neni 31****Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32**Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33**Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34

Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35

Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36

Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Paga e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-22-3432-5-2-1/C832

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 1000 me vlefshmëri prej 90dite
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit të kontratës.

	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 60 ditë kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës
Parimet përgjithshme e të pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në tri situacione për punët e kryera dhe të konstatuara nga menaxheri i kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës . Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve (365)
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë
Pagesa shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate

		do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
--	--	--

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2, -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 616-22-3432-5-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: "TRIANGLE" SH.P.K., rr.Brigada123, 23000, Suharekë, Kosovë

E-mail: triangle.shpk@gmail.com

Personi kontaktues: Ukë Baftjaraj

Telefoni: 049 473 653

Faxi:

Numri fiskal: 810048167

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-22-3432-5-2-1

Titulli i kontratës: Renovimi i qendrës kulturore Llukar

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Renovimi i qendrës kulturore Llukar

3. Çmimi total i tenderit është:

114 243,55 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Projekti: Renovimi i Shtëpisë së Kulturës-Llukar
Lokacioni: Prishtinë, Rr.


Vërejtje: Para përcaktimit të çmimit ofertuesi është i obliguar që të vizitojë objektin me qëllim të përcaktimit sa më real të çmimit. Të bëhen verifikimet dhe matjet e hapësirës. Për ngjyra dhe tekstura të konsultohet paraprakisht organi mbikëqyrës.

A. PUNËT E ORGANIZIMIT TË PUNISHTES

PUNËT E ORGANIZIMIT TË PUNISHTES				
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi(€)
1	Rrethimi i truallit, me rrethojë metalike apo me rrethojë në konstrukcion me llaçorinë ose të ngjashme por të sigurt dhe pengesë për të pamundësuar qasjen e qytetarëve dhe personave të autorizuar brenda parcelës, punishtës së ndërtimit për të mos penguar mbarevajtjen e punëve dhe për të siguruar nga lëndimet e mundshme të kalimtarëve të rastit me gjatësi 2m dhe dyerëve provizore për hyrje në punishtë. Pas kryerjes së të gjitha punëve kjo rrethojë duhet të hiqet dhe bartet deri në deponinë e punëkryesit.	m ²	140	1.00
2	Shkyqja e përkoshme e instalimeve ekzistuese si dhe rikyqja e tyre pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe preventivi i konservimit të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funktion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.	kompleti	1	50.00
3	Instalimi i zyrës së përkoshme në punishtë (~12m ²).	kompleti	1	150.00
4	Pastrimi përfundimtar i parcelës. Pastrimi i oborrit (pemet, mbeturinat), Pas përfundimit të punimeve të gjitha materialet e hedhura duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i terrenit rreth objektit.	copë	1	100.00
Shuma:				440.00

B. PUNËT DEMOLUESE



PUNËT DEMOLUESE				
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi(€)
1	Demolimi i tërësishëm i kulmit duke përfshi mbulesën e kulmit, elementet mbajtëse konstruktive dhe shitresat tjera të trajtuara (tavanin, tregullat lëndet e drurit dhe elementet tjera që janë trajtuar) dhe bartja e materialeve të demoluara në deponi të qytetit deri 25 km.	Paushall	1	5000.00
2	Demolimi i mureve të brendëshme (sipas projektit të arkitektures) të konsultohet me mbikëqyrjen e projektit dhe bartja e materialeve të demoluara në deponi të qytetit deri 25 km.	m ²	50	20.00
3	Demolimi i inventarit në gjithë hapësirën e brendëshme, binës me të gjitha elementet përcjellëse dhe elemente të tjera në hapësirën e objektit dhe bartja e materialeve të demoluara në deponi të qytetit deri 25 km.	copë	1	1500.00
4	Demolimi i dyerve dhe dritareve dhe bartja e materialeve të demoluara në deponi të qytetit deri 25 km.	copë	27	10.00
5	Demolimi i tërësishëm i dyshemesë në gjithë hapësirën e objektit dhe bartja e materialit në deponi dhe bartja e materialeve të demoluara në deponi të qytetit deri 25 km.	m ²	362	12.00
6	Demolimi i tërësishëm i bibliotekës dhe bartja e librave në një depo të sigurt dhe kthimi i tyre pas montimit të raftave në hapësirën e re të bibliotekës.	Paushall	1	120.00
7	Demolimi i tërësishëm i pllakës i trajtuar nga materiali i drurit dhe elementeve tjera përcjellëse. Ky pozicion ndodhet tek pjesa e hapësirës së bibliotekës dhe hapësirës së depozitës bibliotekës. Sipas projektit të konsultohet me mbikëqyrjen e projektit dhe bartja e materialeve të demoluara në deponi të qytetit deri 25 km.	m ²	66.6	20.00
8	Demolimi i tërësishëm i shkallëve nga betoni dhe terasës, sipas projektit të konsultohet me mbikëqyrjen e projektit dhe bartja e materialeve të demoluara në deponi të qytetit deri 25 km.	m ²	12	20.00
Shuma:				13,806.00




PUNET TOKËSORE					
KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PUNIME TOKËSORE:					
Nr.	Pozicioni	Njesia	Sasia	Cmimi(€)	Gjithësej(€)
1	Gërmimi i dheut përreth hapësirës së objektit në thellësi deri 100 cm në varësi të lartësisë së themelit ekzistues thellimi i gërmimit ndryshon, mundet me qendër dhe me pak se 100 cm dhe të përmbisur me lartësi h=40 cm dhe gjërësi b=60 cm dhe trau me gjërësi b=30 cm dhe lartësi h=40 cm dhe i cili do të lidhet për themelet ekzistuese dhe të bëhet lidhja duke ankuar armaturat në themelin ekzistues. Para betonimit të latorhet kallesi në atë mënyrë që të mveshet edhe themeli ekzistues me një shtresë 5 cm beton që të ketë një uniformitet dhe bashkëpunim i lidhjes së themelit ekzistues me atë të sanuar. Ky pozicion përfshin komplet perimetrit e objektit.	m ²	110	5.00	550.00
2	Gërmimi i dheut në thellësi deri 0.8 m dhe gjërësi deri 1.0 m, për drenazhim përreth murit perimetrik të objektit dhe këmbi i dheut pas punimit të shtresave mbrojtëse të hidroizolimit dhe termooizolimit si dhe vendosjes së tubit të drenazhimit si dhe ngjeshja e tij në shtresat përkatëse. Kujdes i veçant duhet të kushtohet gjatë gërmimit themeleve që mos të dëmtohen dhe të punohet drenazhimi, hidroizolimi dhe mbushja në kohë të shpejtë ti shmangët motit të keq duke marrë parasysh efektin të mos vij pasojë e shembjes apo cedimit.	m ²	110	5.00	550.00
3	Gërmimi i dheut brenda hapësirës së objektit në thellësi deri 30 cm për shtruarjen e zhavorrit dhe shtruarjen e betonit dhe shtresave tjera nivelizuese. Ky pozicion përfshin komplet sipërfaqen e brendëshme të objektit. Kujdes i veçant duhet të kushtohet gjatë gërmimit që mos të dëmtohet objekti dhe të punohet drenazhimi, hidroizolimi dhe mbushja në kohë të shpejtë ti shmangët efektin të shembjes apo cedimit.	m ²	115	5.00	575.00
4	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorrit të granuluar të fraksionit 0-32 me t=20cm, të bëhet ngjeshja e tij nën shputen e themelit që do të punohet.	m ²	24	6.00	144.00
5	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorrit të granuluar të fraksionit 0-32 me t=8 cm, të bëhet ngjeshja e tij nën pllakën e betonit të dyshemesë së përdhësës.	m ²	28	6.00	168.00
6	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m ² në tërë sipërfaqen e hapësirës së brendëshme të objektit.	m ²	450	0.80	360.00
7	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gypit të drenazhës Ø200 mm të brinjëzuar dhe kyçja në pusëtën e kanalizimit atmosferik.	m ²	129	3.00	387.00
8	Furnizimi shtrirja dhe ngjeshja e materialit mbushës me material vendor që i plotëson kriteret për material mbushës (d=0-120 mm), në qmim të kalkulohet (furnizimi, transporti, planifikimi dhe ngjeshja e cila duhet të arrijë modulën e ngjeshmërisë në trashësi t=30 cm deri në Ms-400 kg/cm ²). Ky material mbushës do të shërbejë për mbushjen e hapësirës tek biblioteka pas demolimit të pllakës në thellësi të mbushjes 170 cm.	m ²	225	2.00	450.00
9	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorrit të granuluar të fraksionit 0-32 me t=20 cm ashtu që të arrihet modeli i deform. Mv= 40Mp nën pllakën e dyshemesë-hapsirë tek biblioteka dhe depoja. Ky pozicion të punohet pas vuarjes dhe ngjeshjes së shtresës materialit mbushës (d=0-120 mm).	m ²	27	5.00	135.00
10	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorrit 16-63mm për drenazhim rreth perimetrit të objektit. Në qmim flogaritet edhe shqyrtimi i ngjeshjes nga ekipi i specializuar,	m ²	140.5	5.00	702.50
Shuma:					4,021.50

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PUNËT E BETONIT:

Nr.	Pozicioni	Gjatë	Njesia	Sasia	Çmimi(€)	Gjithësej(€)
1	Panë e betonit dhe të nivelizimit					
1	Furnizimi, transporti, kallupimi dhe betonimi i pllakës me beton të klasës C-20/25 me trashësi t=14cm mbi shtresën prej zhavorrit të ngjeshur, betonimi i rampave, terasës dhe shkallëve me beton të klasës C-20/25 sipas projektit të arkitekturës. Duhet të bëhet egzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër si dhe prejardhja e materialit. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe prejardhjen e materialit para fillimit të punimeve.		m ²	80.5	70.00	5,635.00
2	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve shtritore në gjithë perimetrit e objektit me beton të klasës C-25/30 me trashësi t=40cm, gjërësi b=60 cm dhe trau mbi shputë të themelit me gjërësi 30 cm dhe lartësi 40cm mbi shtresën prej zhavorrit të ngjeshur, kallupimi dhe betonimi të bëhet sipas shembullit në fig. Duhet të bëhet egzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër si dhe prejardhja e materialit. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe prejardhjen e materialit para fillimit të punimeve.		m ²	43.5	70.00	3,045.00




3	Furnizimi, transporti, kallupimi dhe betonimi i trajeve me dimensione $t=30$ dhe $h=40$ cm mbi muret e objektit të cilët do të shërbejnë si shtangim konstruktiv të objektit dhe njëkohësisht edhe për mbështetjen e konstruksionit të kulmit nga çeliku sipas zgjedhjes arkitektonike, me beton të klasës C-20/25. Duhet të bëhet egzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër si dhe prejardhja e materialit. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe prejardhjen e materialit në të dy anët e murit dhe me gjatësi së paku 40 cm dhe të lakohen lart me qellimi të lidhjes dhe shtangimit të armaturave horizontale të trajeve për uniformitet.	m ³	20	70.00	1,400.00
4	Punimi i cullës, kallupimi (pragut tek hyrjet e objektit) me lartësi 5 cm dhe gjërësi 7 cm. Cullat të punohet nga betoni dhe materiali hidroizolues të lidhet me të.	m ²	10.5	70.00	735.00
5	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së termoizolimit, dhe shtresës rrafshuese "ESTRIH" në dysheme të objektit dhe terrasës. Të shtrohet shtresa gjysëm e presuar e termoizolimit me trashësi $T=5$ cm, (30mm+20mm) - N4, të mbulohet me PE folie, e mbi të të shtrohet shtresa rrafshuese estrih me trashësi $T=5-8$ cm, me llaç çimento 1:3. Llaçi i çimentos duhet të jetë në gjendje gjysëm të thatë. Sipërfaqja e estrihut duhet të ndahet me fugë dilatuese ose të pritët pas punimit. (Vërejtje: estrih betoni duhet të arrij fortësinë e nevojshme). Lagështia e estrihut para shtrirjes së dyshemesë duhet të jetë $< 4\%$. Të jepet ramja tek banjot në drejtim kah ujëmbledhësi me qellim të largimit të ujit.	m ²	365	9.00	3,285.00
Shuma:					14,100.00



PUNET E ARKITEKTURËS					
Nr.	Pozicioni	Njesia	Sasia	Çmimi(€)	Gjithësej(€)
1	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armaturës Ø10 mm në çdo 20 cm në dy drejtimet e objektit dhe e njëjta të realizohet në formë rrjeje (20x20 cm të lakura 5 cm) në zonën e poshtme dhe të sipërme duke paraparë shtrësen mbrojtëse të armaturës në distancë 2.5 cm të ngritur prej nivelit në zonën e poshtme dhe 2.5 cm të ulur për zonën e sipërme për shtrësen mbrojtëse e të gjitha pozicioneve në gjithë hapsirën e objektit, rampave klasa e armaturës S-B 500 B. Duhet të bëhet egzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër si dhe prejardhja e materialit. Kontraktori është i obliguar që të sjellë atëste paraprake dhe prejardhjen e materialit para fillimit të punimeve. Në sasi është përfshirë edhe sasia e armaturës për armimin e shkallëve dhe rampave që do të rikonstruktohen sipas projektit të arkitekturës.	kg	6450	0.90	5,805.00
2	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armaturës Ø12 mm (6Ø - 3Ø në brezin e poshtëm dhe 3Ø në brezin e sipërm të traut përgjat prerjes tërthore të traut, stafat Ø8 mm çdo 20 cm shpërndarje gjatë gjithë gjatësisë së traut.) duke paraparë shtrësen mbrojtëse të armaturës në distancë 2.5 cm, klasa e armaturës S-B 500 B. Duhet të bëhet egzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër si dhe prejardhja e materialit. Kontraktori është i obliguar që të sjellë atëste paraprake dhe prejardhjen e materialit para fillimit të punimeve.	kg	1620	0.90	1,458.00
3	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armaturës Ø12 mm gjatë kallëpimit të themeleve shiritore me form T të përmblisur (8Ø - 4Ø në brezin e poshtëm dhe 4Ø në brezin e sipërm të shpultës së themelit përgjat prerjes tërthore me dimensione h=40 dhe b=60 cm dhe 4Ø në traut e themelit shiritor me prerje tërthore h=40 cm dhe b 30cm, stafat Ø8 mm çdo 20 cm shpërndarje të bëhet gjatë gjithë gjatësisë së traut.) duke paraparë shtrësen mbrojtëse të armaturës në distancë 3 cm, klasa e armaturës S-B 500 B. Duhet të bëhet egzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër si dhe prejardhja e materialit. Kontraktori është i obliguar që të sjellë atëste paraprake dhe prejardhjen e materialit para fillimit të punimeve.	kg	3250	0.90	2,925.00
Gjithësej					10,188.00


PUNET E HIDROIZOLIMIT					
Nr.	Pozicioni	Njesia	Sasia	Çmimi(€)	Gjithësej(€)
